**I.Kuadri Kontabel i Aplikuar.**

Pasqyrat financiare te periudhes 01.Janar.2018-31.Dhjetor.2018, ne perberje te te cilave jane Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci),Pasqyra e Performancës(Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve),Pasqyra e Fluksit te Parase,Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapital, ne date te mesiperme, jane pergatitur ne baze te kerkesave te Ligjit nr.9228 date 29.04.2004*Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*,nenet 4 deri 18 te ketij ligji dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit te vendit tone.
Bilanci ne perberje te pasqyrava financiare tregon pozicionin financiare(aktivet,pasivet dhe kapitalin) te Shoqerise* **ARIFAJ** *shpk me date 31.12.2018.
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve tregon perfomancen ekonomike(te ardhurat, shpenzimet dhe fitim/humbjen)te Shoqerise* **ARIFAJ** *shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.
Pasqyra e fluksit monetar tregon fluksin e parave(Arketimet dhe pagesat ne para dhe ekuivalentet e saj) te Shoqerise* **ARIFAJ** *shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital neto tregon ndryshimet ne kapitalin e Shoqerise * **ARIFAJ** * shpk per periudhen 01.01.2018-31.12.2018.

**II . Politikat kryesore kontabele.**

Nje permbledhje e pjeses me te madhe te politikave kontabel te aplikuara ne Pasqyrat financiare jane sa me poshte:

**II.1. Mjetet Monetare.**

Per Mjetet monetare ne arke dhe ne banke eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Vlera e drejte * ,sipas paragrafit nr.11-27 te SKK-se nr.3.Mjetet monetare ne monedha te huaja jane vleresuar ne monedhen baze me kursin e Bankes se Shqiperise qe daton 31.12.2018.

**II.2. Te drejta te Arketueshme.**

Per *Te drejta te arketueshme* te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto historike minus zhvleresimin e mundshem* ,sipas paragrafit nr.11-27 te SKK-se nr.3.Per vitin aktual vleresimi i tyre eshte bere me vleren nominale ne krijim te tyre.

**II.3. Inventari**

Per Inventarin e paraqitur ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto historike*,sipas paragrafit nr.14,15 te SKK-se nr.4.Kostoje eshte llogaritur duke perdorur Metoden e mesatares se ponderuar.

**II.5. Aktivet Afatgjata Materiale.**

Per Aktivet Afatgjate Materiale te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto historike minus amortizimin e akumuluar ne vite* ,sipas paragrafit nr.11-19 te SKK-se nr.5.Amortizimi I AAM eshte llogaritur sipas metodes te percaktuar ne Ligjin 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat",i ndryshuar.

**II.7.Detyrimet Afatshkurtra.**

Per *Detyrimet Afatshkurtra* ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto e amortizuar * ,sipas paragrafit nr.11-27 te SKK-se nr.3.

**II.8. Detyrimet Afatgjata.**

Per *Detyrimet Afatgjata* te paraqitura ne daten e mbylljes se bilancit 31.12.2018 eshte aplikuar politika kontabel e vleresimit *Kosto e amortizuar* ,sipas paragrafit nr.11-27 te SKK-se nr.3.

**II.9.Kapitali**

Vlera e kapitaleve dhe perberesve te tij eshte vleresuar me vleren e tyre historike kontabel. Ndryshimet ne grupin kapitale kane ardhur jo si rezultat I ndonje SKK-je.

**II.10.Te Ardhurat dhe Shpenzimet.**

Vleresimi I te Ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere mbi bazen e parimit te konstatimit te drejtave dhe detyrimeve ne momentin e ndodhjes.Vleresimi I tyre eshte bere sipas percaktimeve ne paragrafet 30-36 te SKK-se nr.1 dhe te SKK-se nr.8.

**III. Informacion-Shtese per zerat Materiale.**

**III.1.Mjetet Monetare.**

Gjendja e *Mjetet Monetare* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Banka | 87,050.9 | 662,727.6 | (575,676.7) |
| Arka | 607,802.6 | 1,782,505.9 | (1,174,703.3) |
| Vlera arke (Pulle Akcize) | - | - | - |
| Totali | **694,853.5** | **2,445,233.5** | **(1,750,380.0)** |

Mjetet monetare jane paraqitur ne bilanc sipas gjendjeve te llogarive bankare ne daten e fundit, 31.12.2018, e cila eshte e njejte me ekstratet e fundit te bankave per kete periudhe si dhe me gjendjen e arkes se Shoqerise ne fund te muajit Dhjetor 2018.Gjendjet sipas bankave dhe arkes paraqitet ne aneksin shtese **III.1.MM.**

**III.2. Te drejta te Arketueshme.**

Gjendja e * **Te drejtave te Arketueshme** * me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Nga aktiviteti i shfrytëzimit | 365,266,619.8 | 288,381,217.8 | 76,885,402.0 |
| Nga njësitë ekonomike brenda grupit | - | - | - |
| Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse | - | - | - |
| Të tjera | 934,654,051.9 | 910,427,087.5 | 24,226,964.5 |
| Kapital i nënshkruar i papaguar | - | - | - |
| **Totali** | **1,299,920,671.7** | **1,198,808,305.2** | **101,112,366.5** |

**Te drejtat te Arketueshme** krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar rritje,ne strukture Te drejtat e Arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit kane rritje ne vleren 76,885,402 leke , Te drejtat e Arketueshme te tjera kane rritje ne vleren 24,226,964.50 leke.Per vitin aktual ka rritje te kredidhenies afatshkurter nga shoqeria.Inventari kontabel i * **Te drejtave te Arketueshme** * paraqitet ne aneksin shtese **III.2.A.**

**III.3. Inventaret.**

Gjendja e *Inventareve* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme | 10,003,269.9 | 24,248,769.7 | (14,245,499.8) |
| Mallra | - | - | - |
| Parapagime për inventar | - | - | - |
| **Totali** | **10,003,269.9** | **24,248,769.7** | **(14,245,499.8)** |

***Inventaret*** krahasuar me vitin e kaluar kane pesuar ulje,ne strukture *Lendet e Para* kane ulje ne vleren 14,245,499.80 leke .Nga gjendja dhe blerjet ne vitin ushtrimore kane kaluar ne koston e ushtrimit vlera 415,378,988.61 leke. Inventari i *Stokut * paraqitet ne aneksin shtese **III.3.I.**

**III.4.Aktivet Afatgjata Materiale.**

Gjendja e *AAM-ve* sipas grupimeve ne strukture me date 31.12.2018 paraqitet si me poshte:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Toka dhe ndertesa | 24,091,185.0 | 24,926,433.0 | (835,248.0) |
| Impiante dhe makineri | 47,270,337.0 | 59,599,984.2 | (12,329,647.2) |
| Te tjera instalime dhe pajisje | 69,683,254.2 | 82,501,228.6 | (12,817,974.5) |
| Parapagime për aktive materiale dhe në proces | - | - | - |
| **Totali** | **141,044,776.2** | **167,027,645.8** | **(25,982,869.6)** |

Ne total *Aktivet Afatgjata Materiale* kane ulje neto ne vleren 25,982,869.60 leke,kurse shtesat, pakesimet ,amortizimet dhe vlera e mbetur ose kostoja e amortizuar paraqitet si me poshte:

| | Ndertesa | Ndertime dhe instalime te pergj | Makineri Pajisje | Mjete transporti | Te tjera aktive | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Aktive te Trupezuara* | | | | | | |
| Gjendje 01.01.2018 | 30,356,590.0 | - | 122,703,033.1 | 179,502,888.0 | 11,814,477.5 | 344,376,988.6 |
| Shtesa | - | - | 1,237,000.0 | 4,099,882.0 | 610,386.2 | 5,947,268.2 |
| Pakesime | - | - | - | - | - | - |
| Gjendje 31.12.2018 | **30,356,590.0** | - | **123,940,033.1** | **183,602,770.0** | **12,424,863.7** | **350,324,256.7** |
| *Amortizimi* | | | | | | |
| Gjendje 01.01.2018 | 10,152,431.7 | - | 58,380,774.3 | 102,232,215.0 | 6,583,922.1 | 177,349,343.1 |
| Shtesa | 835,247.9 | - | 13,566,646.9 | 16,274,111.0 | 1,254,131.1 | 31,930,137.0 |
| Pakesime | - | - | - | - | - | - |
| Gjendje 31.12.2018 | **10,987,679.6** | - | **71,947,421.2** | **118,506,326.0** | **7,838,053.3** | **209,279,480.1** |
| | | | | | | |
| *Vlera neto 01.01.2018* | 20,204,158.3 | - | 64,322,258.7 | 77,270,673.0 | 5,230,555.3 | 167,027,645.4 |
| *Vlera neto 31.12.2018* | **19,368,910.4** | - | **51,992,611.8** | **65,096,444.0** | **4,586,810.4** | **141,044,776.6** |

Inventari kontabel i * Aktivet Afatgjata Materiale * paraqitet ne aneksin shtese **III.2.A.A.**

## III.6.Detyrimet afatshkurtera.

Gjendja e ***Detyrimeve Afatshkurtera*** me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Titujt e huamarrjes | - | - | - |
| Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | 1,340,756.7 | 555,652,747.2 | (554,311,990.5) |
| Arkëtime në avancë për porosi | - | - | - |
| Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 551,090,976.2 | 399,641,719.0 | 151,449,257.2 |
| Dëftesa të pagueshme | - | - | - |
| Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit | - | - | - |
| Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka IP. | - | - | - |
| Të pagueshme ndaj punonjësve dhe SSHSH. | 22,530,374.0 | 23,805,404.0 | (1,275,030.0) |
| Të pagueshme për detyrimet tatimore | 25,332,166.5 | 6,643,257.1 | 18,688,909.4 |
| Të tjera të pagueshme | - | - | - |
| | 600,294,273.3 | 985,743,127.1 | (385,448,853.9) |

***Detyrimet Afatshkurtera*** kane pesuar ulje ne krahasim me vitin e kaluar.Ne strukture te grupit rezulton se *Detyrimet ndaj institucioneve të kredisë* kane ulje ne vleren 554,311,990.50,*Te pagueshmet per aktivitetin e shfrytezimit* kane rritje ne vleren 151,449,257.20 leke, *Te pagueshmet ndaj punonjesve dhe SSHSH* kane ulje ne vleren 1,275,030 leke, *Detyrimet Tatimore* kane rritje ne vleren 18,688,909.40 leke.Inventari kontabel i * Detyrimeve Afatshkurtera* paraqitet ne aneksin shtese **III.6.D.A.**

### III.6.1.Detyrimet Tatimore.

Gjendja e *Detyrimeve Tatimore* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Tatim mbi fitimin | 7,327,264.0 | 1,978,752.0 | 5,348,512.0 |
| TVSH per tu paguar | 17,063,105.5 | 4,485,080.1 | 12,578,025.4 |
| Sigurimet Shoqerore e Shendetsore | 2,891,328.0 | 1,804,877.0 | 1,086,451.0 |
| Akcize | - | - | - |
| Tatim mbi e ardhurat personale | 455,223.0 | 175,330.0 | 279,893.0 |
| Tatime e taksa te tjera | 486,574.0 | 55,195.0 | 431,379.0 |
| Totali | **28,223,494.5** | **8,499,234.1** | **19,724,260.4** |

Detyrimet tatimore jane me te uleta se viti kaluar.Ne strukture *Shteti-TVSH per tu paguar* paraqitet me mbetje me te larte ne vleren 17,063,105.50 leke.Tepricat e mbetura te detyrimeve tatimore i perkasin periudhes se Nentor-Dhjetorit 2018 te cilat jane likujduar ne Janar 2019 sipas datave te percaktuara ne ligje te vecanta tatimore.

### III.7.Detyrimet afatgjata.

Gjendja e *Detyrimeve Afatgjata* me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | *Ndryshimi +/-* |
|---|---|---|---|
| Titujt e huamarrjes | - | - | - |
| Detyrime ndaj institucioneve të kredisë | 550,549,953.8 | 94,951,617.4 | 455,598,336.3 |
| Arkëtime në avancë për porosi | - | - | - |
| Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | - | - | - |
| Dëftesa të pagueshme | - | - | - |
| Të tjera të pagueshme | - | - | - |
| Totali | **550,549,953.8** | **94,951,617.4** | **455,598,336.3** |

***Detyrimet afatgjata*** kane rritje ne krahasim me vitin e kaluar ne vleren 455,598,336.30 leke. Ne strukture Detyrimet afatgjata perbehen kryesisht nga huate e marra nga Bankat e nivelit te dyte per nje afat mbi nji vit dhe *Qerate Financiare*.Inventari kontabel i * Detyrimeve Afatgjata* paraqitet ne aneksin shtese **III.7.D.A..**

### III.8.Kapitali.

Gjendja e grupit te Kapitaleve me date 31 Dhjetor 2018 paraqitet:

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 | Ndryshimi +/- |
|---|---|---|---|
| Kapitali i Nënshkruar | 233,723,000.0 | 233,723,000.0 | - |
| Rezerva të tjera | 31,718,015.8 | 8,122,710.5 | 23,595,305.3 |
| *1.Rezerva ligjore* | - | - | - |
| *2.Rezerva statutore* | - | - | - |
| *3.Rezerva te tjera* | *31,718,015.8* | *8,122,710.5* | *23,595,305.3* |
| Fitimi i pashpërndarë | - | - | - |
| Fitim / Humbja e Vitit | 21,250,002.0 | 23,595,305.3 | (2,345,303.2) |
| **Totali** | **286,691,017.9** | **265,441,015.8** | **21,250,002.0** |

Kapitali ne strukturen e tij ka ndryshime:**1.** *Fitim/Humbje te vitit financiar* ne vleren 21,250,002.05 leke qe ka lidhje me fitimin neto te realizuar ne vitin ushtrimor 2018.Kapitali i Ortakerise nuk ka ndryshime ne pronesi, zoterohet nga Ortaku i Vetem ne masen 100%.Vlera kontabel e Kapitalit te Ortakerise eshte ne vleren nominale 233,723,000 leke.Ndryshimet dhe levizjet e kapitalit ne grup dhe ne dy vitet e fundit eshte dhene ne Pasqyren e Ndryshimeve ne Kapital.

## I.K.8.Fitim/Humbja e Vitit Financiar.

Fitim/Humbja e Vitit Financiar 2018 eshte rezultante e Te ardhurave ushtrimore dhe Shpenzimeve ushtrimore.Ne pasqyren e meposhteme do te paraqitet formula e Fitim/Humbjes te Vitit Financiar ne dy periudhat e fundit ne krahasim:

| **Te ardhura** | | *31 Dhjetor 2018* | *31 Dhjetor 2017* | ***Ndryshimi +/-*** | *ne %* |
|---|---|---|---|---|---|
| | Nga shitjet | 973,958,437.41 | 862,075,568.39 | 111,882,869.02 | 112.98 |
| | Te tjera | - | 1,666,500.00 | (1,666,500.00) | |
| **Kosto e shitjeve** | | | | | |
| | Shitje mallra e sherbime | (896,990,266.25) | (824,617,713.29) | (72,372,552.96) | 108.8 |
| | | | | | |
| **Fitimi nga veprimtaria** | | 76,968,171.16 | 39,124,355.10 | 182,588,921.98 | 196.73 |
| | | | | | |
| | Të ardhura të tjera financiare | 1,531,657.49 | 763,411.25 | 768,246.24 | |
| | Shpenzime financiare | (46,068,605.60) | (11,411,791.06) | (34,656,814.54) | - |
| | Pjesa e fitimit/humbjes nga pje | - | - | - | |
| **Fitimi Bruto** | | 32,431,223.05 | 28,475,975.29 | 3,955,247.76 | 113.89 |
| | Shpenzime te pazbritshme | 42,110,250.39 | 4,061,824.31 | 38,048,426.08 | |
| **Baza llogaritjes se Tatim Fitimit** | | 74,541,473.44 | 32,537,799.60 | 42,003,673.84 | 229.09 |
| | | | | | |
| | Tatim Fitimi 15% | 11,181,221.0 | 4,880,670.00 | 6,300,551.00 | |
| **Fitimi Netto per Vitin 2018** | | **21,250,002.05** | **23,595,305.29** | **(2,345,303.24)** | **90.06** |
| | **Caku I Fitimit** | 2.18% | 2.73% | | |

Te ardhurat e ushtrimit ne vleren 973,958,437.41 leke kane ardhur nga:**1.Shitja** e sherbimeve, mallrave e materialeve te realizuara e te faturuara ne vleren 973,958,437.41 leke.Shitjet e tatueshme gjate vitit ushtrimor te raportuara ne FDP jane ne vleren 937,245,391 leke.Ka nje diference me te ardhurat e pasqyruar ne Fitim/Humbje te vitit ne vleren 36,713,047 leke.Diferenca vjen

nga:**1.Rimarrja e** te ardhurave te shtyra per parapagimet e faturuarara gjate vitit 2011 per objektin*BYPASSI SHKODER LOTI1* ne vleren 9,204,384 leke;**2. Rimarrja e** te ardhurave te shtyra per parapagimet e faturuara gjate vitit 2017 per objektin *Rehabilitim i Shkallareve te Sarandes* ne vleren 7,949,214 leke;

**3.Rimarrja e** te ardhurave te shtyra per parapagimet e faturuara gjate vitit 2017 per objektin * Rikonstruksion i Rruges Pylli Sodes,Vlore* ne vleren ,19,559,449.02 leke.Vlera e rimarrjeve te te ardhurave ne vleren 36,713,047.02 leke (R.9,204,384+ R.7,949,214 +R.19,559,449.02) kane dhene rezultat ne shtimin e te ardhurave te ketij viti dhe ne pakesim te postit te bilancit *Të ardhura të shtyra*. Ne shpenzimet ushtrimore jane perfshire kostoja e lendeve te para e ndihmese,furniturat e ndryshme,shpenzime te tjera,taksat ne kosto,pagat e sigurimet ,amortizimi i Aktiveve Afatgjata Matariale. Fitimi nga veprimtaria eshte rregulluar me rezultatin financiar neto i cili perben Fitimin bruto ose Fitimin paratatimor te vitit ushtrimor.Baza e fitimit tatimor ne vleren 74,541,473.44 leke eshte rezultat i fitimit paratatimor ne vleren 32,431,223.05 leke duke i shtuar shpenzimet jofiskale ne vleren 42,110,250.39 leke.Tatim fitimi faktik i vitit eshte llogaritur ne vleren 11,181,221 leke. Fitimi neto per vitin ushtrimor 2018 mbetet ne vleren 21,250,002.05 leke. Ne informacionet shtese eshte bere nje analize me e hollesishme e *Shpenzimeve te tjera nga Veprimtarite e shfrytezimit* qe zene peshe ne koston e ushtrimit.

Kontabilisti I Shoqerise

**Blerta Kerpaçi(Leci)**

Perfaqesuesi Ligjor

**Artan BOKÇIU**

Tirane ,15 Shkurt 2019